



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHITIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-7936 /23 datë: 24.03.2023



Npi – 01/111 datë: 29.03.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 29.03.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -III- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 29.03.2023 (e mërkurë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, z.Arton Demiri, znj.Shkurte Mustafa, dhe znj.Shkurte Behluli. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: z.Ibrahim Demiri nga ZKKK-ja, z.Reshat Gashi nga njësi për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, z. Muharrem Haziri nga OSBE-ja, dhe znj.Arianita Beqa – Rraci nga UNMIK-u.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 01.03.2023,
2. Diskutim për vizitat në disa shkolla dhe në familjet e komunitetit rom dhe ashkali,
3. Raport i punës së ZKKK-së për muajin mars 2023,
4. Diskutim për manifestimin e 08 prillit – Ditës Nacionale të Komunitetit Rom,
5. Diskutim për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave,
6. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

znj.Shkurte Mustafa; Përshëndetje, mendoj se duhet me e futë si pikë shtesë, çështjen e plotësimit të Zyrës për komunitete dhe kthim me një zyrtarë të ri meqenëse z.Ibrahim Demiri shkon në pension.

z.Besnik Seferi; Shqetësues është fakti, që nuk ka ende konkurs për shefin e zyrës për komunitete. Unë mendoj se ne si Komitet mundemi me e bërë një rekomandim për këtë çështje, ose si propozim që del nga kjo mbledhje e komitetit.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Konstatoi Kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi renin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 01.03.2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, te pika kur kemi fole për braktisjen e nxënësve nga shkollat e mesme, duhet të përmirësohet numri i tyre nga 81 sa është shkruar në 5 nxënës, sepse mendoj se është bërë gabimisht.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Konstatoi Kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin, nga mbledhja e KPK-së e mbajtur më 01.03.2023.**

Pika 2

Diskutim për vizitat në disa shkolla dhe në familjet e komunitetit rom dhe ashkali

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Rrezartë Ramadani; Përshëndetje, me datën 17.03.2023 kemi bërë vizitë në disa shkolla. Te shkolla profesionale janë 26 nxënës të komunitetit pakicë. Dy prej tyre e kanë braktisur shkollën. Në shkollën e mesme "Naim Frashëri" janë 3 nxënës të komunitetit pakicë, njëri e ka braktisur shkollën dhe janë mbetur 2.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Në shkollën e mesme "Naim Frashëri" në fakt janë 4 nxënës e jo 3. Unë i di këto të dhëna sepse unë vetë punoj te organizata "Vois of Roma".

znj.Shkurte Mustafa; Te gjitha shkollat na kanë thënë se i kanë ekipet për parandalimin e braktisjes së shkollës shkollës, kështu që para se me u larguar nxënësit ata kanë biseduar me ta, mirëpo ata kanë këmbëngulë.

z.Besnik Seferi; në këto vizita kemi qenë bashkërisht, dhe ne duhet ta japim një mesazh të qartë, sepse shkollat po ballafaqohen me këtë problem. Te shkolla profesionale kanë thënë se nuk kanë fare bashkëpunim. Kemi pa raste që e kanë lënë shkollën për arsye se nuk ka pas kush kujdeset për nënën. E mirë ishte se komuna e Shtimes njihet për bashkëpunimin e mirë me komunitetin pakicë. Ne si komitet nuk do të ndalemi me vizita.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, unë po lidhem me rastin e kësaj familje, që ka thënë se nuk ka kush me u përkujdesur për nënën, kjo nuk është e vërtetë, sepse në atë familje ka edhe vajza të tjera edhe nuse, që ka kush përkujdeset. Por unë mendoj se fjala është për martesat e hershme, unë do të interesohem për këtë rast.

z.Muhamet Mehmeti; Sa i përket këtij rasti unë kam biseduar me të dy prindërit, dhe ata janë të interesuar për me u shkolluar. Mirëpo siç e ceku Artoni, problemi është te martesat e hershme, kështu që ne duhet me bërë çmos për me e bindur për me vazhduar shkollimin.

znj.Rrezartë Ramadani; Unë kisha thënë me e organizuar një fushatë për sa i përket shkollimit. Te shkolla fillore "Lasgush Poradeci" ekziston ekipi, dhe aty kishte vetëm një rast të braktisjes së shkollës për arsye financiare.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -III- për vitin 2023, e mbajtur më: 29.03.2023, unanimitisht vendosi që t'i Rekomandoi, Drejtorisë Komunale për Arsimit, që të mbikëqyrë dhe t'i funksionalizojë, "Ekipet për Parandalimin e Braktisjes së Shkollave të Nxënësve" në përgjithësi dhe të Komunitetit Rom dhe Ashkali në veçanti.**

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Fjalën ja dha Rrezartë Ramadani për të prezantuar vizitat te familjet e komunitetit pakicë.

znj.Rrezartë Ramadani; Ne i kemi vizituar 14 familje. Emine Maliqi nuk është e komunës së Shtimes, ajo jeton në Ferizaj, e cila është riatdhesuar së bashku me 4 fëmijë. Nuk ka pronë për ndërtim të shtëpisë. Ka gjetë strehim të përkohshëm në Ferizaj, si dhe Sherif Maliqi, i cili është banorë i komunës së Shtimes sepse merr ndihma sociale në komunën e Shtimes. Besnik Mehmeti, po ashtu është në listën për ndërtim. Pjesa tjetër që i kemi vizituar kanë nevojë për renovim e jo për ndërtim, mirëpo i kanë tokat për ndërtim.

z.Besnik Seferi; Është hera e dytë që po i vizitojmë familjet e komunitetit pakicë. U tha se do të ndërtohen 30 shtëpi në bashkëpunim me shoqatën "Jetimat e Ballkanit" është mirë që ti rekomandojmë Kryetarit për 5 familje të komunitetit pakicë.

z.Muhamet Mehmeti; Edhe unë mendoj se është mirë që me e bërë një pikë të renditë ditës, për mbledhjen e radhës, me qëllim që ta përpilojmë një listë për këtë.

* Komiteti për Komunitete, vendosi që në mbledhjen e radhës të hartoi një listë të familjarëve që kanë nevojë për banim.

Pika 3

Raport i punës së ZKKK-së për muajin mars 2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Fjalën për këtë pikë ja dha z.Ibrahim Demirit.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Përshëndetje, krejt çka u thanë u definuan mirë. Shoqata "Jetimat e Ballkanit" e kanë komisionin e vetë. Raportin e keni marrë me kohë, dhe unë do ta lexoj, e pastaj nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

Kthimi:

Kërkesa për për kthimin e personave të zhvendosur nuk ka pasur gjatë muajit janar, shkurt dhe mars. Ende kemi në zbatim Rregulloren (QRK) Nr.02/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme.

Ministria për Komunitete dhe Kthim ka përgatitur programin i cili ka të bëjë me databazën për personat e kthyer dhe kemi marrë pjesë në dy punëtori për aplikimin e kësaj databaze edhe në nivel lokal.

Kemi njoftuar komunitetet për thirrjen publike të MKK-së dhe vendimin numër 71/2023 të saj, që krijon shtatë pako të asistencës së nevojshme si dhe kriteret që duhet të plotësohen për të realizuar të drejtën për të aplikuar në thirrjen publike.

Në ZKKK kemi përgatitura aplikacionet dhe kemi ndihmuar në plotësimin e tyre të gjithë ata që kanë pasur nevojë për ndihmë.

Nga Lista që kemi në ZKKK kemi ndihmuar në plotësimin e aplikacioneve për:

- *Ndërtimin e shtëpive;*
- *Rinovim të objekteve ekzistues në pronësi të aplikantit dhe në të cilin ai tashmë jeton me familjen e tij;*
- *Materialeve të ndërtimit*
- *Mobileve;*
- *Pajisjet elektrike;*

Presim që një numër kërkesash të aprovohen nga MKK, edhe për qytetarët tanë.

Riatdhesimi:

Kemi vetëm një individ të riatdhesuar-Mufail Mujota, nga Mollopolci, me vendbanim në Shtime, i riatdhesuar nga Zvicra, me dhunë, më 14.02.2023, të cilin e kemi vizituar bashkë me Koordinatorin e Departamentit për Riintegrim-MPB dhe e kemi regjistruar në Sistemin e Menaxhimit të Rasteve(SMR). Përderisa ZKKK ka në zbatim Rregulloren 22/ 2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, janë mbajtur kontakte të rregullta me Koordinatorin Rajonal të Departamentit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar. Nga Kryetari i komunës është marrë vendim për formimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, komfort rregullore.

Kemi hartuar edhe Planin Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integritetit të të huajve në Komunën e Shtimes 2023 - 2025

Aktivitetet për Integrimin e Komuniteteve sipas Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në komunën e Shtimes

ZKKK ka bashkëpunuar me Drejtorinë e shkollave dhe ka përcjellë vijimin e nxënësve të komuniteteve. ZKKK ka pranuar 8 kërkesa për mbështetje financiare për çështje të renovimit të shtëpive dhe ndihma për mbulimin e shpenzimeve për barëra-shëndetësi. Kërkesat janë kompletuar dhe presim që të fillojë punën Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për subvencione.

Kemi bërë Thirrjen publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për projektet e OJQ-ve që janë në interes të komuniteteve jo shumicë. Presim aplikacionet dhe pastaj do t'i shqyrtojmë projektet.

Është themeluar Komisioni Komunal Veprues, i cili do të bëjë monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planit të Veprimit 2022-2024. Koordinator i KKV-së, nga Kryetari i komunës, është emëruar Lulzim Sahiti, zyrtar i lartë për informim.

Përmes Kryetarit të komunës i kemi drejtuar kërkesë MFPT-së që të na mundësojë aprovimin e numrave për dy zyrtarë në ZKKK, për të cilët duhet të shpallet konkurs. Nëse marrim këtë aprovim ZKKK do të kompletohet me stafin minimal që duhet të ketë: shefin e ZKKK-së, zyrtarin për kthim dhe zyrtarin për të drejta të komuniteteve.

Në bashkëpunim me QPS-në jemi përkujdesur që të gjitha familjet e komuniteteve rom dhe ashkali, që janë në listën e asistencës sociale, të përfitojnë pako ushqimore, të cilat QPS ka siguruar në prag të muajit të Ramazanit.

I kemi drejtuar një kërkesë Fondacionit "Amaneti", me seli në Prishtinë, që mundësisht të ndihmojë me pako ushqimore dhe higjienike një numër familjesh që kanë më së shumti nevojë për ndihmë gjatë muajit të Ramazanit.

Projektet në terren për komunitetet dhe përfituesit si dhe bashkëpunimi me palët e interesit

Në takimin me IOM-in janë identifikuar përfituesit e mundshëm të Programit EU për Stabilizimin e Komuniteteve V (EU CSP V) ku komuna ka të nënshkruar Marrëveshjen e bashkëpunimit me IOM-in. IOM-i ka vizituar disa familje që mund të jenë përfitues potencialë të Projekteve e që nuk kanë përfituar më herët. Vizita është bërë te: Haxhë Bajrami, Hyzri Mehmeti, Habib Tahiri, Fadil Mehmeti, Shkëlzen Osmani.

Buxheti:

Për këtë periudhë kemi arritur që të alokojmë buxhetin prej 4 mijë euro, prandaj edhe kemi bërë thirrjen publike për OJQ-të. Gjithashtu presim realizimin e kërkesave që kemi pranuar.

Pika 4

Diskutim për manifestimin e 08 prillit – Ditës Nacionale të Komunitetit Rom

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Arton Demiri; Vitet e kaluara i kemi kërkuar 300 euro për me shkua në Prizren sepse atje është organizuar manifestimi qendror, por tash më atje nuk po funksionon, kështu që tani ne po organizohemi vetë për të rriturit dhe kemi menduar që ta kalojmë një mbrëmje te restoranti "Roma" në Shtime, ku gjithsej jemi 15 anëtarë.

z.Muhamet Mehmeti; Unë nuk e kamë të qartë pse patjetër kërkesat me i bërë te ZKKK-ja, për këtë qëllim, pse jo te DKRS-ja që ka mundësi me i përkrahë sepse janë pakë dhe kanë mundësi me i përkrahë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; E vërtetë që janë pak 15 persona të komunitetit rom, por unë nuk e di nëse kanë mundësi DKRS-ja me e përkrahë këtë aktivitet.

Pika 5

Diskutim për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Rrezartë Ramadani; Unë e kam pranuar materialin, por nuk kam pa diçka. të veçantë për komunitetin.

z.Muharrem Haziri, nga OSBE; Atë që po e thotë Rrezarta, realisht ti Kryesues duhet me ditë, sepse ti e merr edhe materialin e Kuvendit, dhe ky material u është dërguar juve me kohë, por vetëm duhet të shfletohet për sa i përket bartjes së buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual. Unë e kam thënë disa herë dhe po e përsëris se është shumë me rëndësi që të merrni pjesë në dëgjimet publike për

shpërndarjen e buxhetit të komunës, ku mund të kontribuoni drejtpërdrejt në projekte të caktuara, e jo të kërkohet pasi të përmbyllet çështja e buxhetit.

z.Muhamet Mehmeti; Është hera e parë që marr pjesë në komitet pa e lexuar materialin. Unë jam duke e përgatitur një dokument për buxhet, ku kanë me u përfshi edhe aktivitetet por edhe shpenzimet për manifestimet që organizohen për festa. Pasi ta finalizoj këtë dokument do ta bisedoj edhe me ju.

Pika 6

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; U bisedua këtu për shpalljen e pozitës së shefit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për me u marrë me këtë çështje më me urgjencë. Sugjeroj që me e bërë një takim me Kryetarin për këtë çështje. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Mehmeti; Në takimin që e kemi pas me Kryetarin, ne e kemi pa vullnetin e Kryetarit, se do të përkrahet dhe se do të pranohet më i miri normalisht më profesional.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Konstatoi Kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -III- për vitin 2023, e mbajtur më: 29.03.2023, unanimitisht vendosi që t'i Rekomandoi, Kryetarit të Komunës dhe Zyrës së Personelit, që të ndërmarrë të gjitha masat ligjore për zëvendësimin me kohë të shefit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, z.Ibrahim Demiri, me arsyetimin se në muajin Maj 2023, ky shkon në pension.**

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe punën, meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoi në ora 15.57h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

